

KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

Sot më datë 01.05.2023, lidhet kjo kontratë dhurimi aksionesh ("**Kontrata**") ndërmjet palëve të mëposhtme (veçmas referuar si "**Pala**" dhe në nunrin shumës si "**Palët**");

DHURUESIT: **Z. Asiap Gruda**, shtetas shqiptare, lindur në Dibër, më datë 11.05.1969 me numër identifikimi personal (NID) G90511057P, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim referuar si "**Dhuruesi**");

Z. Albert Gruda, shtetas shqiptare, lindur në Dibër, më datë 28.07.1975 me numër identifikimi personal (NID) H50728124S, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim referuar si "**Dhuruesi**");

PRANUESI I

DHURIMIT: **Znj. Jona Josifi**, shtetase shqiptare, lindur në Durrës, më datë 14.06.1989, i identifikuar nr. personal I95614060T, madhore e me zotesi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim referuar si "**Pranuesi i Dhurimit**").

MEQENËSE

- A) Dhuruesit **Z. Asiap Gruda dhe Z. Albert Gruda** janë ortakë me të drejta perkatesisht prej 20% dhe 40% në shoqërinë ““P & C Solutions ” Sh.p.k” (në vijim referuar si "**Shoqëria**"), NUIS M02010008P, me seli në Tiranë Rruga: “LALMZ.K. 2376, Vol 4, faqe 125 me nr pasurie: 100/9.. dhe zotërues i pjesëmarrjeve perkatesist prej 20% dhe 40% të kapitalit të Shoqërisë, e përbërë nga 1 kuotë secili, me vlerë nominale perkatesisht prej 20,000 Lekë dhe 40,000 lekë, të cilët nuk janë të renduar me barrë apo kufzime të tjera në favor të të tretëve;
- B) Dhuruesit dëshirojnë të dhurojnë nga 1 kuotë secili me vlera nominale perkatesisht 20,000 Lekë dhe 40,000 lekë, pa asnjë kusht apo barrë, Pranuesit të Dhurimit, i cili pranon;

Në këto kushte, Palet bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 - Objekti

- 1.1 Objekt i kësaj Kontrate është dhurimi pa asnjë kusht dhe kalimi në favor të Pranuesit të Dhurimit të 1 kuotë secili me vlera nominale perkatesisht 20,000

Lekë dhe 40,000 lekë, që përbejnë 60% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 2 - Dhurimi

- 2.1 Palet bien dakord se me nënshkrimin e kësaj kontrate nga Palët, Pranuesi i Dhurimit bëhet zotërues me të drejta 60% i kuotave të dhuruara, sipas përcaktimit të nenit 1 më sipër dhe Dhuruesi zhvishet nga çdo e drejtë e detyrim në lidhje me aksionet e dhuruara.

Neni 3 - Të ndryshme

- 3.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi e prodhon efekte të plota me nënshkrimin e saj nga Palët, dhe përbën të gjithë marrëveshjen mes Palëve lidhur me objektin e saj.
- 3.2 Palët bien dakord që kjo kontratë dhurimi do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë kontratë dhurimi do të zbatohen parashikimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi dhurimin.
- 3.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për të zgjidhur mosmarrëveshjet që Palet nuk mund t'i zgjidhin me mirëkuptim ndërmjet tyre.
- 3.4 Kjo Kontratë dhe kalimi i Aksioneve nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) nga secila prej palëve.

Kjo Kontratë Dhurimi hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) faqe dhe në 3 (tre) ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe.

DHURUESIT

Z. Asiap Gruda



Z. Albert Gruda



PRANUESI I DHURIMIT

Znj. Jona Josifi

